

Shtojca 20



**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor: **Drejtoria Rajonale e OSSH Tirane**

Ankesë drejtuar: **Komisionit të Prokurimit Publik.**

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

SILVER SHPK

Nuis/Nipt

K88010301S

Adresa

Tiranë

Qyteti

Shqipëri

Shteti

1001

Kodi Postar / Posta

+355674851514

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

shpksilver@gmail.com

E-mail

Linard BALANI

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

+355674851514

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

2023/09/27

Data (viti/muaji/dita)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

REF-80868-09-21-2023



2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur	Procedurë e hapur e thjeshtuar
☒	☐
Procedurë e kufizuar	Procedurë konkurruese me negociim
☐	☐
Partneritet për inovacion	Dialog konkurrues
☐	☐
Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit	Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
☐	☐
Shërbim Konsulence	
☐	
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP	
☐	

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Drejtoria Rajonale e OSSH Tirane

4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

(Vlera e përlogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

32,253,174.3 (tridhjetë e dy milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatedhjetë e katër pike tre)leke(pa TVSH)

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).

Shërbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH sh.a dhe objektet në administrim të FSHU sh.a

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

2023/10/12

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit
(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

8. Data e nënshkrimit të kontratës
(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)
Ligjin Nr.162/2020 date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik", VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☒ X

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.
(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

- Pavlefshmëri kontrate

☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Hartimi i kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike nuk është bërë në përputhje me LPP dhe RrPP.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Pasi u njohem me DT të procedurës me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH sh.a dhe objektet në administrim të FSHU sh.a”, konstatuam disa mangësi në hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit.

Neni 11, pika 1 e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” parashikon se:

1. Në procedurat e prokurimi tmb ikufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Neni 97, pika 1 e V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, indryshuar, parashikon se:

1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entitkontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedura te prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

Bazuar sa më sipër po paraqesim këtë formular ankese duke kërkuar modifikimin e kritereve të kualifikimit, specifikimeve teknike si dhe duke kërkuar disa sqarime.

Neni 77, iligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” parashikon se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket për shtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entetkontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer

shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose entikontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entetkontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhироja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur për masat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e 48 duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në fjesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve

Neni 41, i V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të

fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një entepublik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatuave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", sipërvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmëri në për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

c) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të për caktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktor të heqë si kritere ato që nuk janë objekt i kësaj procedure si dhe kane si qëllim uljen e eficiencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik

Neni 2, iligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" parashikon se:

Qëllimi këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Bazur në nenin 111 ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", paraqesim ankesën tonë, mbi Dokumentat e Tenderit, publikuar nga Autoriteti Kontraktor:

Se pari:

Mbi ankesën:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Në DST, Kriteret e Veçanta për Kualifikim, pika 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë kërkohet që, Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë licencat e mëposhtme:

Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (Stacion transferimi për mbetje jo terrezikshme), (Kodi III.2.A)

Bazuar në ligjin Nr. 52/2020 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR

Neni 11 Shfuqizime

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, çdo parashikim për lejet e mjedisit të tipit C, në ligjin nr. 162/2014, "Për mbrojtjen e cilesisë së ajrit në mjedis" dhe çdo dispozite tjetër ligjore që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Termi III.1.A ligjerisht i referohet lejes C, bazuar në ligjin nr 52/2020 për disa ndryshime në ligjin Nr. 10448, datë 14/07/2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, Leja C nuk ekziston më dhe në keto kushte AK nuk mund të kërkojë një dokument i cili është shfuqizuar.

Në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorët dhe jodiskriminues:

a) kualifikimi profesional: cdo operator i ekonomik i kerkon licencat profesionale industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per tecilat do te lidhet kontrata;

Kerkojme te hiqet ky kriter nga kerkesat e vecanta per kualifikim si nje kriter i pabazuar ne Ligj.

Se dyti:

Ne piken 2.3 kapaciteti teknik, nen pika 2.3.2, si dhe ne procesverbalin e argumentimit :

2.3.2 Operatori/ëtekonmik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 38 (tridhjetë e tete) persona të punësuar, te cilet duhet te jene te listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Gusht 2023,në profilet sipas tabelës se mëposhtme:

Stafi	Nr.
Drejtues Teknik	1 (një)
Punonjes sherbimi/Sanitar	30(tetë)
Punonjes I specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë	1 (nje)
Specialist të kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë	1 (nje)
Shofer per transport materialesh	4 (kater)
Shofer per platformen levizese	1 (nje)
Totali I punonjësve	38 (tridhjetë e tete)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

➤ **Për Drejtuesin Teknik OE duhet te paraqese:**

- Diplomë
- Kontrate pune perkatese.
- Duhet të ketë minimalisht 5 (pese) vite eksperiencë pune. Librezë pune ose cdo dokumantacion tjetër qe vërteton eksperiencën perkatese.
Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.
Deklarate nga adminstratori i shoqërisë se drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

➤ **Per punonjësit punonjes sherbimi/Sanitare, te paraqitet vetem kontrate pune perkatese, nga keta te paktën 3 punonjes perpunime ne lartesi te pajisur me certifikata trajnimi per punime ne lartesi(per shkak te pastrimit te fasadave ne lartesi)perndjekien/zbatimin e kontrates.**

- **Për punonjesin e specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” duhet te paraqese:**
- kontrate e pune perkatese

- *Per specialistin e kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë – minimalisht 1(një), sipas Udhezimit të përbashkët APP dhe MSHMS nr 294 datë 06.05.2020 (ose në përputhje me çdo ndryshim që mund të pesojë ky udhëzim përgjatë zbatimit të kontratës) duhet të paraqesë:*

- kontratë e punës

- *Per punonjës të shofere transporti duhet të paraqesë;*

- kontratën e punës dhe

- lejen e drejtimit

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

Duke e argumentuar që:

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic është shërbim pastrimi, stafi i kerkuar është një numër minimal duke u bazuar në nevojën e kryerjes së shërbimit.

Duke pasur parasysh se objekti i kontratës përfshin edhe shpërdarjen e materialeve sipas pikave të përcaktuara në termat e references, është përlogaritur edhe personeli i nevojshëm për realizimin e këtij detyrimi. Përlogaritja është bazuar në ndarjen rajonale të Drejtorive dhe të KNK-ve.

Per Drejtuesin Teknik: Kërkesa mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit ... 1. Puna dhe nësi ngarkon një ose disa punëmarres, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje /institucion, Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet detyrës dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas

standarte veligjore ne fuqi. Garantimi I ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Përpunonjesin e specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë: Ky person i licensuar kërkohet dhe cmohet i nevojshëm prania e tij gjatë zbatimit të kontratës me qëllim mbrojtjen e shëndetit fizik dhe mendor dhe të sigurisë së punëmarrësve, si dhe në përmirësimin e kushteve të punës.

Per specialistin e kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë: Ky person i licensuar kërkohet dhe cmohet i nevojshëm prania e tij gjatë zbatimit të kontratës për shkak të shmangjes së rrezikut nga agjentët kimikë lidhur me solucionet që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit nga ana e operatorit ekonomik.

Per punonjesit shofere transporti: Kerkohen 4 shofere per transportin e materialeve te nevojshem per kryerjen e shërbimit duke pasur parasysh shpërndarjen gjeografike.

Duke qene se per kryerjen e shërbimit kerkohet nje platformë lëvizëse për ngritjen e njerëzve, përpunimet në lartësi është i nevojshëm dhe shoferi per platformen levizese.

Autoriteti kontraktor është i pa qarte ne argumentin e kërkeses per drejtuesin teknik, sepse nje kompani, person fizik ose juridik, duke pasur nje llicence qofte edhe ajo e kerkuar nga ana e AK, siç është Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbimendërhyrëse higjieno-shëndetësore (dezinfektim, Dezinfektim dhe Deratizim) kodi II.8.B ka ne borderone e saj nje drejtues Teknik qe kontrollon disponimin dhe menyren e perdorimit dhe sasite e nevojshme te biocideve dhe detergjenteve si dhe perzierjet perkatese qe behen ne momentin e shërbimit te pastrimit si dhe te dezinfektimit, prandaj do ishte e tepert kerkesa, per specialistin e kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë.

Ne lidhje me kërkesen qe per drejtuesin teknik duhet te kete:

- Diplomë
- Kontrate pune perkatese.
- Duhet të ketë minimalisht 5 (pese) vite eksperiencë pune. Librezë pune ose cdo dokumantacion tjetër qe vërteton eksperiencën perkatese.
Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e lëshuar nga e - albania.
Deklarate nga administratori i shoqërisë se drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Mendojm qe është kriter abuzues kerkesa ne nje drejtuesi teknik qe duhet te kete 5 vite pune si drejtues teknik sepse kjo do te mos lejonte konkurrence te plote te disa OE qe do te kufizoheshin nga nje kriter i tille.

Ne lidhje me kërkesen e nje punonjesi te specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë kjo kerkese mund te mbulohet shume mire me emertimin e nje punonjesi pergjegjes te certifikuar.

Duke qene se AK objektin e prokurimit e ka “Sherbimi i pastrimit dhe dezinfektimit per objektet e OSSH sh.a dhe objektet ne administrim te FSHU sh.a”, do ishte e nevojshme ndryshimi i emertimit te punonjesve sipas listes bashkangjitur:

NR.	Stafi	Nr.
1	Drejtues Teknik-	1 (një)
2	Punëtore sanitare	30 (tridhjetë)
3	Punonjes per punime ne lartesi	3 (tre)
4	Punonjes dezinfektimi	4 (Kater)
	Totali I punonjësve	38 (tredhjet e tete)

Se treti:

Ne piken 2.3 kapaciteti teknik, nen pika 2.3.5, si dhe ne procesverbalin e argumentimit :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

1. Makineri thithese pluhurash dhe lengjesh-minimumi 10 cope
2. Makineri larje-tharje-minimumi 3 cope
3. Fshesa korenti –minimumi 10 cope
4. Paisje për larjen e dritareve me gjatësi mbi 10 metra - 1 cope

1. Makineri thithese pluhurash dhe lengjesh:

- a. Tipi I punes : pluhura dhe lengje
- b. Kapaciteti I vakumit :minimum 2200 mm/ss
- c. Vellimi I kazanit : minimum 20 litra
- d. Fuqia motorike : minimum 1300W
- e. Rezervuar plastic
- f. Filteri pastrueshem

2. Makineri Larje-Tharje:

- a. Gjeresia e furces:minimum 400mm
- b. Presioni I furcave :minimum17g/cm²
- c. Gjeresia e thithjes : minimum600mm
- d. Performance praktike : minimum 1000m²/ore
- e. Rezervuari I ujit te paster : minimum 30 litra

3. Fshesa korenti:

- a. Tipi I punes : pluhura
- b. Vakuumi :minimum 2200mm/ss
- c. Vellimi : minimum 6 litra
- d. Fuqia motorike : minimum 1000W
- e. Filteri pastrueshem

4.Pajisje per Iarje ne dritareve / fasadave: Minimalisht duhet te permbaje keto specifikime:

- a. Membrane te kundert osmoze
- b. Pajisja e filtrit: filtra active e karbonit, I pajisje de-jonizuese rezine
- c. Pajisje karbonime fibert eleskopike 13.5 mm bajtese dore me meter
- d. Pluhur per membrane oznotike te filtrit te mirembajtjes
- e. Tubikullimi
- f. Lubrifikues I copezuar

Per te provuar disponimin e makinerive profesionale me parametra te kerkuar,te shtojca per katese per specifikimet te knike, operatori ekonomik duhet te paraqese kataloge / skede teknike per makinerite profesionale ,ku te pasqyrohen te dhenat e kerkuara mesiper.

Për makineritë me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës object prokurimi e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore /zhdoganim/kontrate blerje).

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetë deklaramit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 tëVendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme lidhet me parashikimet e termavete references dhe kërkesave per realizimin e shërbimit. Keto pajisje/makineri te kerkuara shërbejnë për realizimin e proceseve të punës të parashikuara në terma reference si dhe duke qenë se shërbimi do të ofrohet në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në rreth 161 objekte është vlerësuar të kërkohej një numër minimal makinerish/pajisjesh që deshmojnë se operatori ka kapacitetin për realizimin e shërbimit

Makineri thithese pluhurash dhe lengjesh

Pajisja është projektuar për të pastruar në sipërfaqe të thate dhe të lagësht, duke e bërë të persosur për pastrime në mjedise të ndryshme, duke marrë parasysh dhe fuqinë, pajisja heq në mënyrë efektive pluhurin, papastërtitë, derdhjet e lengjeve etj. Makineria e thithjes së pluhurave në të thate dhe të lagësht mund të përdoret në mënyrë shumë komode si në ambientet e brendshme dhe të jashtme, duke marrë në konsideratë dhe ambientet e Autoritetit ku janë të brendshme dhe ballkone ose obore të jashtme, gjithashtu dhe numrin prej 161 ambiente, arsyetojmë se minimalisht për të plotësuar nevojat duhen 10 cope.

Mendojmë që ky kriter duhet të zëvendësohet me një deklaratë për kapacitetin e pajisjeve teknike që disponon sepse duke marrë shkas nga pika 4 që AK kërkon Pajisje për larjen e dritareve me gjatësi mbi 10 metra- 1 cope si dhe është vetëshpehur që kjo procedurë shërbimi do të ofrohet për 161 objekte në të gjithë territorin e Shqipërisë është komplet e pa qarte se ku, në çfarë mënyrë dhe objekti do të përdoret kjo pajisje, si dhe për më tepër AK nuk e përcakton se sa nga keto m², kanë nevojën për shërbimin e fasadës së jashtme dhe për më tepër këtu është kërkuar edhe makineri vinç me koshte pa levizshëmderi në një lartësi prej 30m.

Deklarata që mund të plotësojë çdo OE për pajisjet dhe produktet që do të përdori (certifikata e konformitetit ose cilesisë CE, jep një garanci shumë të lartë për shërbimin) që ka në dispozicion si dhe ato që mund të ketë ose marrë me qira dhe paraqitjen e skedave teknike mund të zëvendësojë shumë më mirë këto kërkesë me një deklaratë me poshtë:

Pajisjet teknike Materialet e pastrimit dhe produktet			OSHEE
Nr.	Emertimi I produktit	Vendi I origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			
3			
Etj.			

Si dhe do ishte më e drejtë duke qenë se kjo procedurë ka një volum shumë të madh shërbimi dhe për mundësimin e ofertimit edhe nga OE që nuk i disponojnë aktualisht të gjitha keto pajisje të bëhet me deklaratë që në momentin e njoftimit të fituesit të paraqitet kontratë e blerjes së pajisjeve të nevojshme për mundësimin e kësaj procedure, duke qenë se kemi të bëjmë me pajisje që mund të blihen dhe të gjenden kollaj në tregun tonë.

Se katërti:

Ne piken 2.3 kapaciteti teknik, nen pika 2.3.8, si dhe ne procesverbalin e argumentimit :

2.3.8Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Licence DDD te vlefshme, (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim).

Ne kete kuader OE duhet te provoje disponimin e minimumi 10 pompa dezinfektimi (Pompa profesionale per sperkatjen e dezinfektantit me depozite minimumi 15 litra), 5 pompa ULV, dhe 1 pajisje mjegulluese qe te operojë me parimin e injektimit të lëngshëm në gazrat e nxehta. Për vërtetimin e disponimit te ketyre pajisjeve, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat e blerjes/zhdoganimit/kontrata qeraje së bashku me specifikimet teknike të pajisjes (të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe). Termat e shërbimit do te jene sipas percaktimeve te Udhezimit te perbashket te APP dhe MSHMS nr. 294, date 06.05.2020.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) pompa motorike të montueshme në automjet për kryerjen e shërbimit në ambientet e jashtme, me kapacitet 300 litra ose më shumë.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Faturat Tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi, kontrate qiraje si dhe specifikimet teknike të pompës, të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe, së bashku me dokumentet e makinave (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, foto të makinës me aparatit e montuar).

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë licensen dhe pajisjet e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Licence DDD te vlefshme kerkohet pasi ne termat e references eshte parashikuar te ofrohet edhe shërbimi i Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim. Gjithashtu te gjitha pajisjet e kerkuara me lart lidhen ngushtesisht me proceset e punes se shërbimit DDD te kerkuar ne termat e references.

AK kerkon pajisje per shërbimin e Dezinfektimit por “harron” te shtojte se per perdorimin e tyre duhen punonjes te shërbimit te dezinfektimit te licensuar dhe jo vetem pajisje te licensuara, kerkon qe per kete shërbim OE te jete i pajisur me 2 pick si dhe 2 (dy) pompa motorike të montueshme në automjet për kryerjen e shërbimit në ambientet e jashtme, me kapacitet 300 litra ose më shumë???????, Per cilin shërbim te jashtem u dashkan 2 pick – up???????

Kerkojm qe AK te reflektoje ne keto kerkesa, deri diku absurde sepse nese AK do te kerkonte specifikimet teknike lidhur me kete sherbim, ato duhet te ishin listimi i te gjitha preparateve te nevojshme per kryerjen e ketij sherbimi qe te cilat futen ne listen e biocideve si dhe kane nevojte per futjen ne tregun tone si dhe nevojen e nje Akt autorizim importi per lendet biocide sipas V.K.M nr.933 Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg...

Prandaj duhet qe me ane te nje deklarate OE te percaktonte pajisjet dhe lendet aktive qe do te pedorte per sherbimin e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit qe mund te ishte si me poshte:

Pajisjet e sherbimit dhe produktet			OSHEE dhe FSHU
Nr.	Emërtimi I produktit që do të lahet	Vendi I origjines së produktit të nastrimit	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			
3			
Etj.			

Ne si OE mendojm qe kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qënë pjesëmarrës, komisionin e vlerësimit të ofertave në mënyrë të tillë që procesi i vlerësimit të mos kryhet me subjektivizëm, por të vendosë në situatë të barabartë edhe personat me aftësi të kufizuar, duke mospenguar kështu pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Kriteret për kualifikim vendosen në mënyrë që autoriteti kontraktor të krijojë një panoramë të qartë mbi kapacitetet ekonomiko – financiare, tekniko – profesionale dhe eksperiencën e operatorëve ekonomikë që janë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Sa më lart, gjykojme se, përcaktimi i kriterëve për kualifikim, së pari, janë te paqartë, dhe së dyti, nuk janë në frymën e legjislacionin për prokurimin publik i cili kërkon që të përcaktohen saktë termat, emërtimet apo specifikimet teknike dhe në mënyrë të tillë që të kuptohen nga te gjithë OE si dhe te jene gjithëperfshires per te gjithë OE dhe jo subjektiv kundrejt nje OE

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo



(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail: shpkSilver@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

Linard BALANI

